



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.**



Nr. _____ Prot

Tiranë më _____._____.2025

**PROCES VERBAL I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE ARGUMENTIMI PËR BLERJE PAJIME SPECIALE**

Tiranë më 09.10.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

I mbajtur nga Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, ngritur me urdhër Nr.1287, datë 03.10.2025 për “Ngritjen e Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit për procedurën **“Pajime Speciale”**.”

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Pajime Speciale” lloji i procedurës “e hapur”

Baza Ligjore

- Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”,
- Ligji 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.162/2020, “Për prokurimin Publik”
- VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me vendimin nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarrë në procedurat e prokurimit publik”,
- Vendimin e Asamblesë së Përgjithëshme me nr. 01, datë 07.04.2025 “Për Miratimin e Projekt Buxhetit 2025 të Shoqërisë “Illyrian Guard sh.a”
- Regjistrin e parashikimeve dhe kërkesën e Drejtorit Administrativ nr. 1498, datë 17.09.2025 me lëndë “Kërkesë për nisjen e procedurës së prokurimit me objekt “Pajime speciale (dedektorë metali, elektrik dore) “.
- Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” i ndryshuar me Ligjin 90 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 75/2014, “Për Shërbimin Privat Të Sigurisë Fizike”
- Udhëzimi 150, datë 16.08.2024 “Për Funksonimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të Shërbimit”

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Autoritet Kontraktues : **“Illyrian Guard” Sh.A**

2. QËLLIMI I PUNËS

2.1. Të Përgjithshme

- Baza ligjore e cila mundëson realizimin e kompletimit me pajime/pajisje të punonjësve nëpërmjet këtij projekti është si më poshtë:

- **Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” i ndryshuar me Ligjin 90 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 75/2014, “Për Shërbimin Privat Të Sigurisë Fizike”**

Argumentimi: Ky ligj u jep të drejtën Subjekteve të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike midis të tjerave dhe bazën ligjore për kompletimin dhe përdorimin e pajisjeve të cilat trajtohen sipas kërkesave të legjislacionit për masat shtesë të sigurisë publike dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Ky ligj për punonjësin e shërbimit të SHPSF-së mundëson përdorimin e forcës fizike dhe pajisjet e mjetet e tjera, të dhëna për përmbushjen e detyrës, vetëm kur kjo është e nevojshme dhe nëse masat e tjera nuk kanë dhënë rezultat, në përputhje me kriteret e përshkallëzimit të saj.

Subjekti i SHPSF-së për realizimin e shërbimit vë në dispozicion të punonjësve të shërbimit mjete e pajisje shërbimi të pajisura me autorizim nga Drejtoria Vendore e Policisë

- Udhëzimi 150, datë 16.08.2024 “Për Funksonimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të Shërbimit”

Ky udhëzim u jep të drejtën Subjekteve të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike të njohin dhe kompletojnë punonjësit/objektet/vendrojat me pajisje/pajime shërbimi në funksion të kryerjes së detyrës. Subjektet e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike, për realizimin e detyrës, në varësi me specifikat e shërbimit i pajisin punonjësit me:

- a) armatim personal, në përputhje me parashikimet e ligjit “Për armët”;
- b) pistoleta elektrike;
- c) *bodygard's spray*;
- ç) jelek antiplumb;
- d) hekura lidhës;
- dh) shkop gome;
- e) elektrik dore;
- ë) radio ndërlidhje;
- f) detektor dore;
- g) maskë gazi;
- gj) dylbi;
- h) helmetë;
- i) rrip multifunksional.

Në funksion të kryerjes së detyrës në shumë prej objekteve/institucioneve punonjësit/objektet/vendrojat pajisen dhe me mjete të tjera shtesë të kontrollit të personelit dhe të mjeteve, me qëllim parandalimin e futjes së lëndëve speciale dhe mjeteve të rrezikshme, varësisht nga kërkesat e subjekteve përfituese të shërbimit të sigurisë. Konkretisht kompletimi me dedektorë të dorës është domosdoshmëri në disa institucione dhe objekte të rëndësishme që kërkojnë një kontroll më të rreptë për një sërë shkaqesh që kanë të bëjnë jo vetëm me institucionin por edhe më personelin që punon në të.

SHPSF-të, për blerjen e armëve dhe pajisjeve të shërbimit, aplikojnë *online* në sistemin *e-Albania* nga Drejtuesi Teknik i SHPSF-së, duke plotësuar të dhënat e përgjithshme dhe specifike në formularin e aplikimit, si dhe duke ngarkuar në sistem dokumentet sipas llojit të shërbimit që kërkohet.

- Mjetet dhe pajisjet speciale të shërbimit të SHPSF-së përdoren nga punonjësit e shërbimit vetëm gjatë ushtrimit të veprimtarisë për të cilën shoqëria është licencuar.
- Pajisjet e shërbimit të SHPSF-së ruhen dhe sigurohen në vende të sigurta, në zbatim të kërkesave dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
- VKM Nr.177, datë 04.04.2019 “ Për krijimin e shoqërisë “Illyrian Guard” SH.A”
Argumentimi: Ky vendim themelon bazat ligjore për funksionimin e “Illyrian Guard” SH.A, duke legjitimuar aktivitetet e saj në sektorin e sigurisë.

Qëllimi kryesor:

- Të sigurohet kompletimi i punonjësve të shërbimit të sigurisë me pajisje/pajime speciale për kryerjen e shërbimit me cilësi, brenda standarteve të kërkuara, në përputhje me Ligjin

2.2. Specifikimet teknike për pajisjet e shërbimit që duhen blerë

1. Dedektor dore për metalet

- Të jenë portative dhe të mbahet e përdoren lehtësisht me dorë
- Të jetë i thjeshtë në përdorim
- Të jenë precizë/të saktë dhe përdoren për kontroll të detajuar fizik.
- Të ketë hapësirë sa më të madhe skanimi duke filluar me thellësi nga 5-10 cm dhe gjerësi 15-20 cm diametër.
- Të kenë sensitivitet të lartë në zbulimin e metaleve qofshin këto edhe në përmasa të vogla
- Të japë shënjë me anë të sinjalit akustik ose dridhje në momentet kur dikton metal
- Të ketë reagim të shpejtë e të menjëhershëm në dhënien e sinjalit të alarmit
- Të ketë ndjeshmëri të regullueshme për të shmangur alarmet false
- Alarmi të jetë me sinjalizim të shumfishtë (vibrim, zë dhe ndricim LED)
- Të ketë llampë sinjalizuese LED për të treguar gjendjen e punës së pajisjes, duke treguar me 3 ngjyra (jeshile/pajisje e ndezur, portokalli/bateri e dobët dhe e kuqe/alarm për dedektim)
- Buton për eliminimin e ndërhyrjeve të jashtëme (shufra apo murre metalike, ora etj)
- Të jetë i kompletuar me bateri
- Bateria të sigurojë funksionimin normal të pajisjes për një afat kohor nga 10-40 orë
- Bateritë të jenë të rikarikueshme
- Pajisja të ketë garanci jo më pak se 2 vjet

2. Elektrik dore

- Të realizojë ndricim me një fuqi jo më të vogël se 1000 LM
- Të jetë i kompletuar me mbajtëse/kompakt për tu vendosur në rripin multifunksional të punonjësit të shërbimit.
- Të jetë i pajisur me bateri të rikarikueshme
- Reze e gjatë për kontrollin e terrenit dhe objekteve në kushtet e errësirës dhe pamjes së kufizuar
- Disa nivele ndricimi
- Të rezistojë i ndezur në funksion të ulët jo më pak se 10 orë pa u karrikuar.
- Elektriku të jetë i kompletuar edhe me kabllin dhe pajisjen e karikimit
- Të realizojë funksionin për zmadhimin, zvogëlimin dhe fokusimin e dritës/ndricimit
- Rezistencë ndaj ujit dhe goditjeve
- Pajisja të ketë garanci jo më pak se 2 vjet
-

KOMISIONI PËR HARTIMIN E SPECIFIKIMEVE DHE FONDIT LIMIT